



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

PROCESVERBAL

Tiranë, më 12.12.2019, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Fatjona Dhimitri – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

1. Seancë dëgjimore me përfaqësues të Fakulteteve të Gazetarisë dhe Drejtësisë për projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 97/2013 “Për mediet audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (*komision përgjegjës*).
2. Diskutimi i projektligjit: “Per ratifikimin e memorandumit të mirëkuptimit ndërmjet qeverisë së Republikës së Shqipërisë (Këshilli i Ministrave) dhe qeverisë së SHBA-ve për programin e shkëmbimit akademik “Fulbright” (*komision përgjegjës*).

Marrin pjesë:

Fatjona Dhimitri, Milva Ekonomi, Fidel Ylli, Ramazan Gjuzi, Musa Ulqini, Vilma Bello, Ismet Beqiraj, Fadil Nasufi, Bujar Çela, Almira Xhembulla, Lindita Nikolla, Mirela Kumbaro, Kostaq Papa, Klajdi Qama, Selami Jenishehri, Erion Piciri dhe Sadi Vorpsi (zëvendësues).

Mungojnë:

Adelina Rista, Enada Kapllani, Amra Barova.

Të ftuar:

Elir Puto- pedagog i Fakultetit Juridik në Universitetin e Tiranës,
Erjona Muçollari- pedagoge e Fakultetit Juridik në Universitetin e Tiranës,
Mark Marku- pedagog i Fakultetit të Filologjisë në Universitetin e Tiranës,
Aleksandër Lela- pedagog i Fakultetit të Filologjisë në Universitetin e Tiranës,
Agron Gjekmarkaj- pedagog i Fakultetit të Filologjisë në Universitetin e Tiranës,

Drita Rira- pedagoge e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja në Universitetin e Tiranës,
Vjola Adhami- pedagoge e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja në Universitetin e Tiranës,
Dorina Berdufi –pedagoge në Universitetin “Aleksandër Moisiu”, Durrës,
Lorena Liceni- pedagoge në Universitetin “Aleksandër Moisiu”, Durrës,
Ardian Hoti- pedagog në Universitetin “Luigj Gurakuqi”, Shkodër,
Ismet Kallaba- pedagog në Universitetin “Luigj Gurakuqi”, Shkodër,
Irina Radu- përfaqësuese nga OSBE-ja,
Elira Canga - përfaqësuese nga OSBE-ja
Ermira Zharri- përfaqësuese nga OSBE-ja.

HAPET MBLEDHJA

Fatjona Dhimitri - Sot në rendin e ditës do të kemi seancë dëgjimore me përfaqësues të fakulteteve të Gazetarisë dhe Drejtësisë për projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 97/2013 “Për mendimet audiovizive në RSH” të ndryshuar.

Të ftuar kemi: Elir Puto, pedagog i Fakultetit Juridik në Universitetin e Tiranës; Erjona Muçollari, pedagoge e Fakultetit Juridik në Universitetin e Tiranës; Mark Marku, pedagog i Fakultetit Filologjisë në Universitetin e Tiranës; Aleksander Lela, pedagog i Fakultetit Filologjisë në Universitetin e Tiranës; Agron Gjekmarkaj, pedagog i Fakultetit Filologjisë në Universitetin e Tiranës; Drita Rira, pedagoge e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja në Universitetin e Tiranës; Vjola Adhami, pedagoge e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja në Universitetin e Tiranës; Dorina Berdufi, pedagoge në universitetin “Aleksandër Moisiu”; Lorena Liceni, pedagoge në universitetin “Aleksandër Moisiu”; Ardian Hoti, pedagog në universitetin “Luigj Gurakuqi”; Ismet Kallaba, pedagog në universitetin “Luigj Gurakuqi”; Irina Radu, përfaqësuese nga OSBE-ja; Elira Çanga, përfaqësuese nga OSBE-ja; Ermira Zharri, përfaqësuese nga OSBE-ja, Kostandin Shkurti.

Fjala për zotin Mark Marku.

Zoti Marku, si mendoni, a e cenon lirinë dhe pavarësinë e medias ky draft i sjellë nga qeveria?

Mark Marku- E nderuar zonja kryetare,

Të nderuar deputetë,

Praktikisht, mesa e njoh procedurën parlamentare, kjo do të ishte një seancë marrje mendimesh për përmirësimet ose ndryshimet që ju mund të bëni gjatë punës në komision për ndryshimet në ligjin për mediat audiovizive. Mendoj se konceptualisht kjo është një procedurë që është jofunksionale për momentin, për shkak se nuk mund të përmirësohet një ligj, i cili cenon lirinë e medias.

Çështja e lirive themelore nuk është çështje e procedurës parlamentare. Meqenëse jemi një vend që tentojmë të shkojmë në Europë dhe në aleancë të vazhdueshme me SHBA-të, po ju kujtoj amendamentin nr.2 të Kushtetutës së SHBA-ve. Ne nuk e kemi në Kushtetutë, por unë mendoj se, meqenëse pretendojmë se jemi kaq proamerikanë dhe proeuropianë, po jua kujtoj se amendamenti nr.1 i Kushtetutës së SHBA-ve thotë se “Shtypi është i lirë dhe Kushtetuta ia ndalon çdo organi ligjvënës që të hartojnë ligje që cenojnë lirinë e medieve”. Kjo ka bërë që për shekuj

në SHBA demokracia dhe mediet të funksionojnë dhe të jenë vendi më i lirë, transparent dhe më i zhvilluar në botë.

Ju jeni futur në një procedurë të një ligji, i cili cenon rëndë lirinë e medieeve. Në këtë kuptim çdo përmirësim ose çfarë mendoni ju se doni të bëni, nuk është përveçse një krim ose bashkëpunim në krim në ezaurimin e lirisë së medieeve.

Unë, si njeri i medias, si pedagog në Fakultetin e Histori - Filologjisë, në departamentin e Gazetarisë, nuk mund të bëhem bashkëpunëtor në një krim kundër lirisë së medieeve, sepse mendoj se do të ishte një gjë shumë e rëndë.

Edhe nga pikëpamja formale, mendoj se ky projektligj duhet të stopohet. Solidarizohem me qëndrimin e organizatave të shtypit, të cilat kanë bojkotuar seancën e konsultimeve dhe kanë bërë thirrje që të mos vazhdohet me këtë procedurë parlamentare për ndryshimet për këtë ligj, sepse cenojnë lirinë e medias.

Keni pasur para një jave një deklaratë të zotit Harlem Desir, përfaqësues i medieeve për OSBE –në në Vjenë, i cili ka bërë vërejtje themelore dhe ka rekomanduar që ky ligj cenon lirinë e medieeve. Ka një deklaratë të organizatave për mbrojtjen e shtypit në Europë, të cilat ju bëjnë thirrje të mos e bëni këtë ligj.

Keni përfaqësues, ekspertë të BE-së, sepse e kam ndjekur me shumë vëmendje para një jave, para se të binte tërmeti, që jua kanë hedhur poshtë ligjin. Unë nuk mund ta mendoj si një ligj, mund të bëhet nga 12 deputetë, kur ka kundër të gjithë sistemin mediatik të vendit, të gjitha organizatat ndërkombëtare që merren me lirinë e medieeve dhe ju të mendoni që përkundër kësaj, të vazhdoni një procedurë për ta përmirësuar. Pra, mua më duket në thelb një paradoks kjo që po bëhet.

Së pari, deklaroj mbështetjen për deklaratën e 15 organizatave, të cilat ju kanë bërë thirrje ta ndaloni këtë procedurë, sepse mendoj se është thelbësore, kjo sepse ju me këtë ligj cenoni, tani po flas si ekspert i medive, cenoni rëndë lirinë e medieeve, për një arsye të thjeshtë. Së pari, ky nuk është ligj, por unë them se është një ligj katastrofik, nga pikëpamja është qesharak. Nuk e di kush e ka bërë, por ai që e ka bërë duhet të ketë turp, sepse është një injorant total në fushën e medieeve.

Prej 30 vjetësh mendoj se edhe një qytetarë i thjeshtë e di që media nuk quhet media e shtypur, por quhet shtypi i shkruar. Media e shtypur ka folur Frojdi, pra ju doni të shtypni median me këtë ligj, që quhet shtyp i shkruar. Ai që e ka shkruar këtë ligj është injorant. Nëse ju doni që me integritetin tuaj parlamentar, me pushtetin që e keni për momentin ta bëni median të shtypur,

siç e keni në ligj, bëjeni, por po ju them se nuk ka për të funksionuar, sepse ne kemi një përvojë në këto 30 vjet të betejave të shtypit me ata që kanë tentuar të cenojnë lirinë e medieeve. Kemi rastin e ligjit në vitin 1994, ju bëj thirrje ta kujtoni këtë rast. Ligji ka qenë i marrë fjalë për fjalë nga një ligj i Veshfalisë në Gjermani, por meqenëse ky ligj ishte korrekt për realitetin gjerman, i bashkuar me një vullnet politik që, në një farë mënyre, në Shqipëri nuk shkonte drejt lirisë së medieeve, por drejt cenimit të lirisë së medieeve, gjeti rezistencë të fortë në media. Unë atëherë kam qenë kryeredaktor gazete dhe kam bërë këtë rezistencë bashkë me kolegët e mi. Ligji u miratua vetëm formalisht, por nuk pati asnjë impakt dhe u detyrua që me mbledhjen e parlamentit të parë, pas atij parlamenti që e kishte nxjerrë atë ligj, praktikisht ligji u shfuqizua. Kështu që mos bëni ligje kot, sepse pavarësisht se ju bëni ligj për ta kufizuar lirinë e mediave, ne do ta vazhdojmë rezistencën tonë dhe ky ligj do të jetë vetëm një ligj në letër, nëse do ta bëni, ama do të jetë për turpin e atyre që do ta bëjnë.

Pse ky ligj shkel lirinë e mediave? Sepse ka një parim bazë në hartimin e legjislacionit për mediet, vetërregullimi, pra normat rregulluese dhe normat vetërregulluese janë qartësisht të ndara në konceptin për rregullimin e medieeve; normat ligjore rregulluese nuk mund të përfshijnë norma vetërregulluese. Aty ku përfshihen...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Mirela, ju lutem, a ka mundësi, se nuk kam ardhur në furgon!

Fatjona Dhimitri - Mirela, të respektojmë personat që na kanë nderuar me pjesëmarrjen e tyre sot. Të tregojmë vëmendje dhe të jemi të kujdesshëm ndaj tyre.

Mark Marku – Për procedurë, nuk kam ardhur në furgon. E lëmë fare, se e di që ju nuk dëgjoni, se ju kanë dhënë urdhër. Unë kam ardhur këtu për të dhënë kohën time, nuk kam ardhur në furgon, se po më duket vetja sikur jam në furgonin e linjës Tiranë- Elbasan.

Fatjona Dhimitri - Jo, ju lutem po flet zoti Marku, nuk ka përse.

Mark Marku – Pak edukatë ju lutem, se jeni pedagoge.

Fatjona Dhimitri – Zoti Marku mund të vazhdoni!

Mark Marku – Moj zonjë, nuk kam ardhur në furgon, po deshe dëgjo, po deshe të iki unë dhe...Ju flisni, bëni muhabet, unë flas, po më duket vetja sikur kam ardhur në furgon.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

E keni bërë parlamentin si furgon dhe doni të na bëni edhe ne, si në furgon.

Fatjona Dhimitri- Ju lutem zoti Marku vazhdoni!

Zonja Kumbaro, mos ndërhyjni ju lutem!

Mark Marku – Trego edukatë, se edukatën e ke detyrim.

Mirela Kumbaro- Qetësohu dhe ruaj etikën!

Fatjona Dhimitri- Zoti Marku vazhdoni!

Mark Marku – Po fole, unë do të ngrihem dhe do t’u bëj thirrje edhe kolegëve të mi të
iklin.

Fatjona Dhimitri- Mund të largoheni ju, zonja Kumbaro, nuk ka pse të largohen të
ftuarit.

Mark Marku- Dhe të shkojmë e ta mbajmë këtë seancë në autobusin e linjës Tiranë-
Korçë.

Kur tjetri flet, mungesë totale edukate, flet edhe ti paralelisht. Nuk ke turp!

Mirela Kumbaro- Ruaj etikën!

Mark Marku – Po ju nuk keni as etikë, as integritet!

Fatjona Dhimitri- Vazhdoni zoti Marku.

Mark Marku – Jeni punëtorë të një njeriu që do të shkelë lirinë e medieve.

Fatjona Dhimitri- Nëse nuk ju intereson ta dëgjoni, vazhdoni të mbron ligjin tuaj.

Mark Marku- Ju jeni punëtorë të një njeriu që do të shkelë lirinë e medias.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Jo, në auditor nuk flas kështu, në auditor jam shumë më i nderuar se duke qenë me ju.

Fatjona Dhimitri- Zoti Marku, ju lutem, vazhdojmë me rendin e ditës!

Mark Marku – Auditorin e kam shumë të zgjedhur. Jam i nderuar shumë.

A mund të flas?

Fatjona Dhimitri - Po.

Mark Marku – Ju lutem, kur flasin të tjerët, unë nuk flas.

Fatjona Dhimitri - Ju lutem, ju bëj thirrje t’i dëgjojmë të ftuarit që na ndihmojnë me
pjesëmarrjen e tyre sot. T’i përkushtohemi rendit të ditës, muhabetet t’i lëmë në kafe, jo këtu!

Mark Marku – Nëse ju nuk jeni shqetësuar, është tjetër; ne jemi të shqetësuar, sepse ky
ligj cenon liritë themelore.

Kostaq Papa - Mos dilni nga konteksti.

Fatjona Dhimitri - Ju lutem, Kostaq, nëse nuk të pëlqen, mund të dalësh edhe ti jashtë.
A ka mundësi të lutem të dëgjoni?

Mark Marku – Idenë e tekstit dhe kontekstin ti nuk e kupton fare.

Fatjona Dhimitri- Ju lutem, vazhdoni! Po, çfarë do të thonë ata. Kini durim të dëgjoni të ftuarit.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Vilma nuk mund të na tregosh ti tani mënyrën si ta drejtoj komisionin. A ka mundësi, ju lutem?

E kontrolloj shumë mirë, nëse nuk ke durim, vazhdo, mund të dalësh edhe ti!

Po, zoti Marku!

Milva Ekonomi – Për procedurë.

Fatjona Dhimitri - Milva, të lutem, po flet zoti Marku tani!

Milva Ekonomi – E ke për detyrë të më japësh fjalën.

Fatjona Dhimitri- Urdhrat nuk i marr nga askush, Milva!

Milva Ekonomi- Kryetare, dje pas mbledhjes bëmë një diskutim për mënyrën se si duhet të trajtoni anëtarët e komisionit.

Fatjona Dhimitri- Ju lutem, anëtarët e komisionit nuk kanë durim të dëgjojnë të ftuarit. Nëse jo, le të shkojnë në kafe dhe të bëjnë muhabetë.

Milva Ekonomi- Ju lutem, mos ma ndërprisni fjalën, më lini të mbaroj!

Nëse nuk kemi zënë mend nga ajo që diskutuam dje për një sjellje shumë etike dhe të kulturuar në komision, duhet ta ripërsëris: Ju lutem shumë, mos të bëjmë të njëjtin gjest edhe sot, sepse nuk shkon kjo mënyrë e komunikimit mes nesh.

Fatjona Dhimitri- Rregullat e komunikimit nuk po i zbatojnë anëtarët tuaj, Milva.

Milva Ekonomi - Ne kemi një rregullore të re të parlamentit, kështu që ju lutem respektojeni atë.

Fatjona Dhimitri- Po, Erion.

Erion Piciri- Ne sot kemi fatin e madh që kemi thirrur pedagogë të gazetarisë të komunikimit, njerëz që nuk kanë lidhje me politikën. Në një moment që unë e kuptoj fare mirë, ligji është diçka e tmerrshme. Ligji ruan jo vetëm çështjen e gazetarëve, por edhe të demokracisë, të interesave të këtij vendi, të grupeve të caktuara. Ju jeni një maxhorancë, jeni minoriteti më i madh, siç thoshte Sartori, por nuk jeni ende maxhoriteti më i madh i këtij vendi, kështu që t'i lëmë njerëzit të flasin, sepse janë profesorë të nderuar. Të respektojmë idetë e njëri-tjetrit. Profesorët të

flasin si të dëshirojnë, si e kanë botën e tyre, një pjesë e madhe janë me formim perëndimor, nuk janë me shkollat e Lanës dhe t'i dëgjojmë, sepse është diçka që i intereson publikut.

Ju jeni maxhoritet, por këtu sot konturohet një maxhoritet i ri, një koncept i ri në lidhje me demokracinë, me shtetin në të cilin jetojmë. Kështu që, ju lutem, i kemi ftuar, t'i dëgjojmë. Ju pastaj, nxirrni konkluzione. Ju i keni votat. Por ju lutem, zërin e njerëzve mos e ndërprisni, sepse me këto teknika e procedura pritet ideja.

Fatjona Dhimitri- Po, zoti Marku.

Mark Marku- Shqetësimi në këtë rast është dyfish i madh, sepse ky ligj, po të kishim Gjykatën Kushtetuese dhe po të kishim sistem drejtësie që të funksiononte mirë, do të rrëzohej në Gjykatë Kushtetuese, sepse bie në kundërshtim me konventat ndërkombëtare. Jua kanë cituar organizatat dje, si edhe sipas deklaratave të OSBE-së, bie në kundërshtim me konventat ndërkombëtare, bie në kundërshtim me Kushtetutën. Kështu që, meqë nuk ka Gjykatë Kushtetuese, ne duam që rezistenca të bëhet këtu, sepse, e para, nuk ka asnjë arsye të bëhet një ligj shpejt. Emergjencia për të cilën është ngritur ky ligj, është thjeshtë një figurë e Kryeministrit. Ne këtu kemi përfunduar që figurat e Kryeministrit i përkthejmë në ligje. Këtu jemi në sistem diktatorial, kap ç'a të kapësh bën një ligj, për kap ç'a të kapësh që të bësh një ligj, një metaforë ta shndërrosh në ligj. Kjo është në vetvete diktaturë. Metafora e kazanit po shndërrohet në ligj, ndërkohë që ekziston një shqetësim real në atë që thotë Kryeministri dhe që është shqetësim i të gjithëve, abuzimi që bëhet me lirinë e fjalës. Ky është shqetësim i të gjitha shoqërive. Të gjitha shoqëritë demokratike, kur vjen puna për të diskutuar për kufizimet e lirisë dhe abuzimeve me liritë, nëse kufizimet ezaurojnë liritë, atëherë prevalenca shkon te më shumë liritë sesa abuzimet, pra, sepse bëhet kjo balance, sidomos në lirinë e fjalës. Shqetësimi që ngrihet këtu për abuzimin me lirinë e fjalës dhe me lirinë medieve, nuk ekziston, ua kanë thënë edhe të tjerët; legjislacioni e rregullon këtë punë. Pra, për atë “shpif”, Kodi Penal dhe Kodi Civil e zgjidh çështjen. Është bërë një debat 4-vjet, kemi luftuar që ta dekriminalizojmë shpifjen me nxitjen e organizatave europiane. Tani ne po bëjmë një ligj tjetër, që atë proces që e bëmë për 4 vjet dhe morëm përgëzimet e BE-së, tani po e kthejmë mbrapsht. Unë nuk e kuptoj a kemi ne objektiva për të shkuar në Europë?! Realisht a duam ne të shkojmë në Europë?!

Me këtë ligj nuk shkojmë në Europë. Do të ketë një kusht tjetër në rekomandimet pas 3 ose 4, ose 5 vjetësh, se kështu do të na thoni ju. Pra, pas 4 vjetësh, prapë një rekomandim shtesë do të jetë që ne ta plotësojmë me këtë që po ndodh këtu.

Në këtë kuptim, unë them se nuk mund të bëhen. Këto shqetësime që ngrihen nga zhurma propagandistike e kryeministrit dhe qeverisë, së pari, janë të zgjidhura me legjislacionin aktual. Së dyti, zgjidhen përmes vetërregullimit. Aty ku vetërregullimi bëhet ligj, jemi në sistem censure dhe diktature. Po ju shpjegoj pse ndodh kjo? Ky nuk është ligj për të garantuar lirinë e medieve, por është një ligj për të kontrolluar mediet aty ku ata nuk janë të kontrolluara ende. Pse? Nëse mediet tradicionale praktikisht rregullohen përmes blerjes, mediet e reja janë një hapësirë e re lirie dhe abuzimi, por nuk është gjetur, meqenëse janë edhe individuale, meqenëse janë në pjesën më të madhe, është e pamundur që t'i kontrollosh. Çfarë po bën qeveria? Meqenëse propaganda e vet i ka dështuar, sepse ka 6 vjet që po i themi qeverisë se propaganda dështon, nëse nuk shoqërohet me rezultate, qeveria ka bërë 6 vjet propagandë të pashoqëruar me rezultate, ju ka dështuar edhe qeveria, sepse nuk dinë parimin themelor të propagandës, propaganda e shfrenuar, siç po bëhet këtu, funksionon vetëm në sisteme diktatoriale, ku ti nuk ke asnjë zë të lirë. Një zë të lirë po të jetë është parim i propagandës, e shkatërron gjithë sistemin e propagandës, që është kundër këtij zëri. Pra, në këtë rast po tentohet që zërat e lirë individualë të sektorializohen. Ato hapësirat e lirisë që janë krijuar në rrjet përmes teknologjive të reja të komunikimit, i ka cenuar dhe dëmtuar përmes blerjes së mediave tradicionale dhe po synon tani të cenojë edhe pjesën tjetër të lirisë së medieve, hapësirën e lirisë në mediat e reja përmes kërcënimeve. Të bashkuara bashkë, do të bëjnë një sistem ku mediet në Shqipëri nuk do të jenë të lira, nuk do të kemi fjalë të lirë, ku do të kërcënohet edhe liria juaj sot, nesër e pasnesër. Ju e keni vënë re si arroganca që përdoret ndaj kundërshtarëve po ju kthehet edhe ju që e mbështetni Kryeministrin dhe këtë arrogancë. Po shikoni si ju trajton gjithandej. Sa më shumë të rritet sistemi i kontrollit, aq më i pakënaqur është ai që ka kontrollin edhe ndaj nuancave të vogla të shfaqjes ose edhe ndaj duartrokitjeve të tepërta, madje edhe nëse ti i thua që marka e vetme është marka Rama, se ky ligj është për të promovuar markën Rama gjithandej dhe në Shqipëri, edhe në botë. Do të na fusë në burg ne nëse, nuk do të promovojmë markën Rama. Pra, edhe po ta promovosh markën Rama, Kryeministri është i pakënaqur, sepse nuk e ke promovuar sa duhet. Pra, unë i bëj thirrje vetëdijes suaj që edhe kur pëlqen tërmetin, si bio, je profesor universitetit dhe pëlqen budallallëqet e Tërmetit, jo tërmetit që ra por Tërmetit Kryetar bashkie, prapë ecën ai, edhe kur i buzëqesh në sy. A e keni parasysh, Enver Hoxha e ngriti diktuarën kundër armiqve të klasës, por, në fakt, zhduku të gjithë bashkëpunëtorët e vet në fund!

Unë po i bëj thirrje vetëdijes suaj dhe integritetit tuaj profesional njerëzor: ajo çfarë po krijoni, do t'ju sakatojë dhe masakrojë edhe ju. Ky ligj për mua është kërcënim për lirinë e

medieve. Kam 30 vjet kontribut në medie, mësimdhënie, jam student i *Generis Suis*, në vitin 1991 dhe më duket paradoksale që pas 29 vjetësh, pasi kam bërë një grevë urie dhe kemi bërë disa protesta, që kemi hedhur poshtë një sistem dictatorial, vijmë tani këtu për të luftuar që të mos vendoset një diktaturë e re. Ky është turpi ynë, paradoksi, fati ynë!

Unë ju bëj thirrje që të paktën në momentin e fundit, ekziston përherë një shans për ta bojkotuar këtë ligj dhe për të mos u bërë bashkëpjesëtar në cenimin e lirisë së medias.

Fatjona Dhimitri- Faleminderit!

Fjala për zotin Lela.

Alfred Lela - Zonja Kryetare,

Zonja dhe zotërinj deputetë, faleminderit për ftesën!

Edhe pse më duket një ftesë e llojit “kofini pas të vjelit”, pra, pak vonë, duket sikur jemi thirrur për fasadën procedurale dhe jo për të dhënë mendime, megjithëse po na lejohet të japim mendime.

Fatjona Dhimitri – Milva, ju lutem të vazhdojë! T’i dëgjojmë dhe të mos i censurojmë sot pa miratuar projektligjin.

Alfred Lela- Zonja kryetare, ju lutem, lërinë të vijnë te Fevziu!

Milva Ekonomi - Unë nuk e quaj këtë “si kofini pas të vjelave”, ju duhet ta tërhiqni! Nuk e quaj kështu, sepse kjo është një detyrë shumë e rëndësishme e komisionit dhe ju jeni këtu, sepse ne e konsiderojmë shumë të rëndësishëm praninë tuaj. Sapo kemi marrë projektligjin, puna e parë që kemi bërë kemi thirrur grupet e interesit. Ju jeni këtu, sepse ky komision ka vendosur që ju jeni shumë të rëndësishëm për t’iu dëgjuar për këtë projektligj që kemi marrë në shqyrtim.

Kështu që, së pari, nuk është e vërtetë kjo që thoni.

Së dyti, projektligji ka mëse një vit që është në qarkullim për të gjitha diskutimet që janë bërë edhe me OSBE-në, edhe me grupe të tjera interesi dhe ju keni qenë i ftuar në disa tryeza që ka organizuar AMA apo OSBE-ja. Unë nuk e di nëse ju keni marrë pjesë ose jo, por emrin tuaj e kemi parë të përfshirë në ato tryeza. Kështu që do t’ju lutesha shumë ta konsideroni këtë gjë një punë serioze të komisionit, për arsyen që ju kemi thirrur këtu.

Fatjona Dhimitri – Po, zoti Lela, mund të vazhdoni!

Alfred Lela – Unë nuk thashë që është joserioze, sepse, ne jse... Për shëndetin e projektligjit e tërheq “kofinin”, por po lë vetëm “të vjelat”. Shiko ku është problemi, zonja kryetare e komisionit, sipas meje. Janë disa paradokse. Paradoksi i parë është se flitet dhe kjo është tematika

e atyre që e mbrojnë këtë ligj, të cilët flasin për një përafrim me legjislacionin e BE-së. Kjo është motoja kryesore. Ndërkohë, në të gjitha vendet e BE-së është vetërregullimi dhe jo rregullimi që prevalon. Këtu është një përpjekje për të hedhur hi syve, për të përdorur kredibilitetin

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fatjona Dhimitri- Ju lutem, mbani qetësi! Vazhdoni, zoti Lela, se këtu është çudi e madhe!

Milva Ekonomi- Mos u fol me këtë gjuhë anëtarëve të komisionit! Çfarë është kjo gjuhë?

Fatjona Dhimitri- Pak respekt, ju lutem për të ftuarit!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Alfred Lela- A mbarove, zotëri? Sikur je tapë mor burrë i dheut! I ke sytë...

Milva Ekonomi- Mos e lejoni...

Fatjona Dhimitri – Ju lutem, të respektoni të ftuarit!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ju po e zhvilloni kështu seancën. Po i ofendoni ata që janë thirrur këtu. Po i censuron.

Halit, të lutem!

Halit Valteri– Asnjë deputeti nuk të lejohet ty t’i drejtohesh a është tapë apo jo!

Alfred Lela – Po çfarë deputeti je ti, mor të faltë Zoti?! A me gjithë mend e ke? E di veten deputet?!

Fatjona Dhimitri – Zoti Lela, ju lutem vazhdoni me rendin e ditës.

Alfred Lela– Janë 15 organizata, që janë pjesë e strukturës europiane, që i kanë dalë kundër ligjit, megjithatë ju thoni se ligji është europian, është në përputhje dhe përafrim me frymën dhe legjislacionin e BE-së! Nuk më duket kështu, sepse, po të ishte kështu, këto 15 organizata që janë afilacione në frymë dhe strukturë të BE-së, nuk do ta shprehnin këtë kundërshtim. Nëse futemi brenda në ligj, është e palejueshme që në këtë shekull dhe në këtë vit t’i jepet një institucioni shtetëror të varur nga shteti, “institucion” po deshët e quajmë, për ta zbutur pak, e drejta për të licencuar, pra e drejta për të hequr licenca të medieve të reja online. Kjo është e papranueshme, është autoritariane, është diktatoriale, quajeni si të doni. Nuk dua të zgjatem, se e shoh që ka shumë parehati këtu me deputetët, me disa prej tyre, sepse për pjesën më të madhe kam respekt. Dua të theksoj për ironi të fatit që jemi në ndërtesën e ish - Komitetit Qendror, ku gjente strehë dikur edhe sektori i censurës dhe propagandës i Komitetit Qendror të Partisë së Punës së Shqipërisë. Ky ligj është një ripërsëritje, një rifrymëzim, një rikthim i sektorit të censurës dhe propagandës.

Bëjeni, në dorë e keni, nuk ju ndalon njeri, se i keni të gjitha, merreni edhe këtë, por sa më shumë të merrni, aq më të afërt e keni përfundimin, për të mos thënë fundin.

Faleminderit!

Fatjona Dhimitri- Fjala për zotin Gjekmarkaj.

Mark Marku- Vetëm diçka, në rastin e funksionit që merr AMA, praktikisht nga autoritetet...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

.....po pse nuk nxelesh kur sillet keq edhe Kryeministri yt, mos zonjë?

Fajtona Dhimitri - Mund të vazhdoni, zoti Marku.

Mark Marku – Nuk mund të sillesh kështu, kur ne nxe kemi për diçka...

(Diskutime pa mikrofon.)

Ju lutem, zonjë, silluni me dinjitet!

(Diskutime pa mikrofon.)

Fatjona Dhimitri – Ju lutem, t’i qëndrojmë rendit të ditës që kemi për sot...

Mark Marku – Pse nuk nxelesh kur të fyen Kryeministri yt, por nxelesh nga fjalët tona?

(Diskutime pa mikrofon.)

Zonjë, nuk e kemi për detyrë të vijmë fare këtu, megjithatë për respekt kemi ardhur. Ju bëni punën tuaj...

Milva Ekonomi – Po, pra, punën tonë jemi duke bërë.

Mark Marku – Duhet të na thoni faleminderit që kemi ardhur.

Milva Ekonomi – Jua kemi thënë këtë.

Mark Marku – Kemi ardhur me turp të madh, sepse kjo që po ndodh është turp! Edhe pse kam kundërshtuar, përsëri kam frikë se mos bëhemi pjesë e ndonjë farse, sepse kështu e bëni ju demokracinë. Hajdeni këtu, sepse ky apo ai kundërshton shumë mirë e të tjera me radhë, ndërsa mua më vjen zor dhe për këtë i kërkoj falje publikut dhe njerëzve të mi me ardhjen time këtu, pasi kam frikë që edhe në këtë mënyrë është një farsë. Ju, më pas, thoni “kemi pasur konsultime”, jo këtë e atë, por po ju them se nuk do ta keni miratimin tonë për këtë çështje që po shqyrtoni dhe as nga ndonjë organizatë tjetër mediesh me mend në kokë, përfshi këtu edhe veten time.

Unë kam qenë relator i ligjit të parë. Ligji i parë që ju...

(Diskutime pa mikrofon.)

Milva Ekonomi – Nuk ka pasur atëherë media *online*.

Mark Marku – Nuk ka pasur atëherë media *online*? Zonjë, kemi qenë ne që kemi futur konceptet e para të medieve *online*, por ju nuk ia keni idenë...

Milva Ekonomi - Është dukuri që ka qenë...

Mark Marku – Media *online* ka vetëm atje në Surret dhe në asnjë vend tjetër të botës. Që në momentin që u bë kështjella atje, filluan mediet *online* dhe rreziku për mediet.

Unë kam qenë relator i një projektligji që është bërë shumë kohë më parë, këtu janë të pranishëm ish-kolegë të mi, si Fideli e të tjerë, të cilët e dinë procedurën se si ka funksionuar.

E para, kemi pritur gati 2 vjet që opozita të ishte e pranishme në komision për të miratuar ligjin. Kemi pasur një ekspert nga Këshilli i Europës, BE-ja, keni të pranishëm Fidelin dhe kolegët e tjerë, një ndër ekspertët më të mirë për mediet në Europë, Iv Solomonin, e cila pas çdo produkti që ne bënim dhe ia dërgonim, na e kthente me 50 faqe, vinte këtu, konsultoheshim dhe për pjesën më të madhe të çështjeve kemi rënë dakord, vetëm për një pikë nuk ramë dakord, zgjedhjen e kryetarit të AMA-s. Pas një procesi gati 5-vjeçar konsultimesh, ekspertizash e të tjerë, arritëm tek ai produkt, i cili gjithsesi nuk është perfekt. Më pas kam biseduar me shumë aktorë dhe e kam parë edhe vetë që në disa aspekte të caktuara kishte probleme, por duhet të mendoni vetëm faktin që për këtë ligj kemi punuar gati 7 vjet me ekspertët më të mirë europiane, organizata ndërkombëtare dhe aktorë të interesit e të tjerë.

Te ky ligj, i vetmi aktor është Kryeministri dhe ju këtë ligj po e bëni vetëm për të, prandaj është e kotë t'i thërrisni aktorët e interesit. Ju, si përfaqësues të popullit, nuk jeni të zotë t'i kundërviheni vullnetit të atij aktori, i vetmi, pasi vetëm ai do të kakarisë në këtë vend. Ai kërkon t'u mbyllë gojën edhe qenve. Pas javësh apo muajsh, kur ta bëni këtë ligj, do të bëni edhe një ligj tjetër, ku të ndaloni qentë të lehin, sidomos kur bën vizita Kryeministri, këtu do të arrini ju.

(Diskutime pa mikrofon.)

Po studiot janë më të lira se ky vendi këtu, se ajo marka jote, zonjë, neve nuk na pëlqen!

Fatjona Dhimitri – Faleminderit, zoti Marku!

(Diskutime pa mikrofon.)

Agron Gjekmarkaj – Mirëdita!

Fatjona Dhimitri – Një sekondë, zoti Gjekmarkaj.

Po, zoti Valteri.

Halit Valteri – Zoti Marku dhe zoti Lela, asnjë prej deputetëve të pranishëm këtu nuk është pro këtij ligji dhe nuk heqim asnjë presje nga ato që ju thoni, që Kryeministri do të kapë

mediet, që kërkon të bëjë një ligj që censuron mediet *online*, që ERTV-ja e historia të tilla. Po ju drejtohem ju të dyve personalisht, pasi jeni ju që i keni bërë fresk nëpër gjithë ata banakë, sepse ato nuk janë televizione, por si banakët e lokaleve, Edi Ramës dhe qeverisë së tij, sa herë ju është lipsur nevoja për t'ju dhënë një kockë dhe për t'i mbajtur ato “porthaletë” që keni, siç ju mban Lul Basha dhe Edi Rama. Në këtë proces ju jeni palë, mirë e thatë, është një farsë që organizohet nga këta burra e gra këtu, që kanë mandatin e deputetit, meqë ne nuk na njihni si deputetë, se nuk na njeh Luli, por kur të na njohë Luli, do të na njohësh edhe ti...

Fatjona Dhimitri – Të lutem, Halit!

Halit Valteri - Po ju them vetëm diçka, zoti Lela, ta tërhiqni fjalën që i thatë zotërisë, sepse është turp për ju si gazetar, jeni figurë publike dhe përfaqësoni një grup interesi kur vini këtu. Na njeh apo nuk na njeh ti si deputetë apo nëse e ndiejmë apo jo ne veten si deputetë, kjo nuk ka fare rëndësi, pasi nua nuk më hyn fare në punë se çfarë mendon ti. Kërkoj ta tërheqësh fjalën që i thatë zotërisë!

Nëse bëhet ky ligj, e mira do të ishte të shtonim edhe diçka, se si financohen këto portale. Kush janë këta biznesmenë nga opozita dhe maxhoranca që i financojnë, duke u dhënë para? Do t'jua nxjerrim edhe me fakte lekët që merrni sa andej-këtej...

(Diskutime pa mikrofon.)

Fatjona Dhimitri – Faleminderit, Halit!

Halit Valteri – Ti po deshe rri, por nëse ke punë dil përjashta...

Fatjona Dhimitri - Zoti Gjekmarkaj, fjala për ju.

(Diskutime pa mikrofon.)

Agron Gjekmaraj - Mirëdita të gjithëve!

Unë nuk e përjashtoj mundësinë që edhe idiotët janë popull, edhe vulgu është popull, edhe idiotët dhe vulgu përfaqësohen në parlament dhe kanë të drejtën e tyre, është logjika dialektike e demokracive, kjo është pjesë e saj. Këtu po ndodhin gjëra shumë të çuditshme, republika e brishtë e Shqipërisë po shndërrohet në sulltanatin e Arnautistanit. Sulltanatet janë mjaft të bukura për t'i treguar në “Përrallat e një mijë e një netëve”, me qilima fluturues e me të tjera ndodhi, por nuk janë të bukura të jetosh në to, jam i sigurt për këtë, sidomos në vitin 2019.

E di që çdonjëri prej nesh, ju këtu dhe ne nga ana tjetër, e kemi të shtrenjtë dhe të dashur karrierën, por jo me çdo kusht atë. Ju jo gjithmonë do të jeni deputetë, sado mirë të silleni, siç e tha edhe zoti Marku, pasi nuk është e thënë që Kryeministri do t'ju përkëdhelë gjithë kohën, pasi

diku do t'i ngelë hatri e do t'ju përbuzë më pas kur të bëjë listat. Nesër fëmijët tuaj do ta drejtojnë këtë vend, ndoshta nuk do të zgjedhin karrierën tuaj, por do të kenë nevojë për hapësirën e fjalës së lirë dhe do të duan të bëjnë profesionin e gazetarit, nuk do të duan të bëjnë profesionin e lakeut apo të servilit, por do të kenë nevojë të kenë hapësirë lirie dhe demokracie.

Zoti Lela u shpreh se është përfshirë në këtë ligj, por nuk do të jetë më, pasi është një ligj që duhet refuzuar dhe përçmuar. Është në dinjitetin tuaj, ndoshta mund ta bëni këtë sakrificë me pak kosto edhe personale, ta refuzoni dhe të mos harxhoni kohë për të menduar për një ligj, i cili tenton që në emër të abuzimit ndaj fjalës, ta vrasë atë, sepse nëse fjala vritet, atëherë nuk ka më nevojë as për amendim.

Faleminderit!

Fatjona Dhimitri – Faleminderit, zoti Gjekmarkaj!

Aleksandër Lela – Mund të ma jepni fjalën?

Fatjona Dhimitri- Po, vetëm për pak, sepse më duhet t'ua jap fjalën edhe të ftuarve të tjerë brenda limitit të kohës që kemi përcaktuar.

Aleksandër Lela – Unë nuk kam ardhur këtu të jap leksione, as e mendoj një gjë të tillë, por dua t'ju flas për konceptin e fjalës deputet. Çfarë është një deputet? Një deputet është dikush që përfaqëson. Në momentin që nuk ka platformë dhe rrafsh përfaqësimi, e cila vjen nëpërmjet votës, e kuptoni vetë se...

Fatjona Dhimitri – Faleminderit!

Fjalën e ka profesori i Fakultetit Juridik, zoti Ilir Futa.

Mark Marku – Siç jua thashë pak më parë, na duhet të largohemi...

(Diskutime pa mikrofon.)

Musa, më vjen keq, nuk mund të të dëgjoj, sepse kam një takim dhe më duhet të largohem...

(Diskutime pa mikrofon.)

Sa i takon pjesës së dëgjimit, ti do të më flasësh, që unë t'i ndryshoj mendimet e mia!?

Musa Ulqini – Jo.

Mark Marku - Nëse keni pyetje. A na keni thirrur si ekspert?

Musa Ulqini – Kam një koment...

Mark Marku – Komente mund të bëni sa të doni, mund edhe të më shani në korridor dhe nuk e kam problem fare. Nëse keni pyetje, jam në dispozicion, por siç jua thashë, kam marrë zonjën

kryetare në telefon dhe i kam thënë: “Po vij për respekt të komisionit”. Në radhë të parë respektin e kam për vete e jo për të tjerët, edhe si një lloj detyrimi për shkak të situatës që është krijuar nëpërmjet këtij ligji. Siç edhe jua thashë, kam një takim tjetër...

(Diskutime pa mikrofon.)

Ju lutem, vetëm pyetje, sepse nuk ka kuptim të diskutoj me ju. Ka një parim retorik: “Me ata që nuk të bashkon asgjë, mos diskuto kurrë, se është humbje kohe.”.

Milva Ekonomi – Megjithatë, edhe pse nuk ju bashkonte asgjë me ata të tjerët, ligjin e kaluar, rradhën e kaluar...

Mark Marku – Jo, na bashkonte interesi i mirë, por ty të bashkon interesi për të bërë një ligj për AMA-n, ky është dallimi.

Fatjona Dhimetri – A kanë pyetje anëtarët e komisionit?

Po, zoti Piciri.

Më fal, zoti Piciri.

Zoti Ulqini, fjala për ju.

Musa Ulqini – Kjo është një seancë dëgjimore dhe në këto seanca ne që i ftojmë të tjerët, duhet t’i dëgjojmë. Unë guxoj ta shkel procedurën parlamentare, sepse e quaj të shenjtë, por dua t’ju them 2-3 mendime.

Së pari, besoj se kjo procedurë është kushtetuese, ligjore dhe demokratike. Me vullnetin tonë kemi bërë diçka, gjë e cila ke vite që bëhet në të gjitha komisionet parlamentare, duke ftuar për të dëgjuar të gjitha grupet e interesit: ata që e kundërshtojnë plotësisht, ata që e quajnë projekt fashist, ata që thonë se duhen bërë ndryshime, si dhe ata që abstenojnë. Kjo është diçka shumë e mirë, nuk është fasadë, por diçka e vërtetë, është një procedurë demokratike.

Kemi ftuar këtu edhe ndërkombëtarët që monitorojnë mediet në Shqipëri, institucionet që kanë përgjegjësi sa i takon kësaj çështjeje, ata që e kanë iniciuar ligjin, trupën akademike, përfaqësues të shoqatave, duke i dëgjuar të gjithë me respekt, pavarësisht mënyrës se si ata janë shprehur, por sot është hera e parë që të ftuarit e tejkalojnë mandatin e tyre si të ftuar, duke paragjykuar deputetët, të cilët i kanë ftuar këtu në respekt të procedurave, ndërkohë që asnjëri prej nesh nuk është shprehur ende. Askush këtu nuk ka të drejtë të paragjykojë asnjë prej kolegëve, pasi nuk e kemi thënë ende atë që mendojmë. Ju për ne jeni profesorë të nderuar dhe nuk mund të na paragjykoni. Jemi këtu nga vota, nuk përfaqësojmë një opinion të pamatur publik, por përfaqësojmë qytetarët që na kanë votuar. Unë jam një njeri që jam votuar nga disa mijëra qytetarë,

me emër të përveçëm, disa herë edhe me listë partie. Jam i pranishëm që nga viti 1992 këtu në parlament dhe e njoh shumë mirë procedurën, procesin; jam njeri që kam kundërshtuar dhe i kam mbështetur gjërat ashtu siç i kam menduar vetë, por ju nuk keni të drejtë të thoni *on block*. Ne nuk jemi shprehur ende dhe në këtë komision, pasi këtu ka njerëz me shumë reputacion dhe përvojë, por edhe nga ata që nuk kanë përvojë parlamentare, kështu që ju nuk e keni këtë të drejtë dhe tagër.

Ju lutem, respektoni gjërat më minimale, të cilat edhe ju, si pedagogë, nuk keni të drejtë t'i shkelni, që janë jashtëzakonisht jetike, nëse duam ta respektojmë këtë marrëdhënie, përndryshe të mos kishit ardhur!

Nuk më ka ndodhur ndonjëherë në këta 24 vjet që trupa profesorësh, të cilët edukojnë gazetarët, të vijjnë këtu dhe na paragjykojnë pa folur ende...

(Diskutime pa mikrofon.)

Fatjona Dhimitri – Të lutem, Musa, të qëndrojmë te rendi i ditë, mos bëni hedhje dhe pritje fjalësh!

Musa Ulqini – E dyta...

(Diskutime pa mikrofon.)

Fatjona Dhimitri – Dështimi është juaji, që po i fyeri të ftuarit, Milva.

(Diskutime pa mikrofon.)

Më mirë iki si kryetare sesa të bëhem pjesë e lojërave dhe të mos respektohen personat që janë të pranishëm.

(Diskutime pa mikrofon.)

Nuk e kam fare problem, nuk e dua pushtetin tuaj.

(Diskutime pa mikrofon.)

Musa, pse e gjithë kjo *indulgjencë*? Në vend që të kemi durimin t'i dëgjojmë ata, të përthithim prej tyre praktikat më të mira...

(Diskutime pa mikrofon.)

Po i censuroni.

Musa Ulqini – Sapo jua shpjegova...

Fatjona Dhimitri – Pse duhet të ftojme këtu ata që doni ju, që të mbrojnë ligjin?

Milva Ekonomi – Ne i kemi ftuar, kush i ftoi ata?

Fatjona Dhimitri - Ju faleminderit, zoti Gjekmarkaj, zoti Lela, profesor Marku!

Milva Ekonomi – E bënë *shoun* ata dhe ikën...

Fajtona Dhimitri – Jo, *shoun* nuk e bënë ata, por po e bëni ju këtu.

Musa Ulqini – Zonja kryetare, dua ta vazhdoj fjalën time.

Fatjona Dhimitri – Zoti Musa, mund të vazhdoni.

Musa Ulqini – E dyta, ky projektligj nuk ka të bëjë fare me shtypin e shkruar, prandaj ju bëj thirrje të gjithëve që jeni këtu të merrni informacion. Shqipëria ka miratuar në vitin 1997 një ligj për shtypin e shkruar me tre nene, kemi aplikuar standardin e Kushtetutës Amerikane.

Në nenin e parë thuhet: “Shtypi është i lirë”.

Në nenin 2 thuhet: “Liria e shtypit mbrohet me ligj”, gjë që nuk është ndryshuar.

Këtë e bëj për të sqaruar opinionin publik, pasi këtu u tha një e pavërtetë e madhe.

Ky ligj nuk ka lidhje me televizionin dhe me radiot. Ne kemi në fuqi një ligj jashtëzakonisht të mirë, i cili është miratuar me votat e maxhorancës dhe të pakicës parlamentare, duke marrë dakordësinë e të gjitha institucioneve ndërkombëtare. Kur është miratuar ky projektligj, ka qenë zoti Mark Marku së bashku me kolegët e opozitës socialiste. Ky ligj nuk ka lidhje fare me televizionet dhe radiot. Me çfarë ka lidhje ky ligj? Ky ligj nuk cenon të drejtën e informimit të qytetarëve shqiptarë dhe të gazetarëve. Sa i përket kësaj çështjeje, ne kemi një ndër ligjet që është më i miri, si dhe institucionet që e garantojnë këtë gjë, siç janë Avokati i Popullit e të tjera. Ky ligj merret vetëm me një çështje, kërkon të rregullojë një shqetësim që ka lindur nga publiku i gjerë, që është një interes publik, i cili diskutohet në Amerikë, në BE dhe kudo. Kush është kjo? Tentimi për të rregulluar mediet *online*.

Pra, media e shkruar, televizionet dhe radiot nuk cenohen, vetëm mediet *online*. Mediet *online* duhet ta rregullojnë këtë shqetësim që është evident, pasi në Shqipëri ka 700 medie *online*.

Ky projekt ka ardhur nga qeveria, por mund të kishte ardhur edhe nga komisioni ynë dhe nga 20 mijë qytetarë. Në dhjetor të vitit të kaluar qeveria e ka publikuar projektin, jemi përsëri në dhjetor, ka kaluar gati 1 vit, që do të thotë se asnjë gjë nuk është bërë fshehtas pa ardhur në tavolinat e parlamentit, duke iu nënshtruar disa ekspertizave. Më vjen keq që shefi i Departamentit të Gazetarisë, që edukon gazetarët, të thotë një të pavërtetë të jashtëzakonshme, duke e quajtur ligj “fashist”. Çfarë thotë “Zëri i Amerikës”? “Zëri i Amerikës” thotë: “Varianti fillestar ka pësuar ndryshime, pas shqetësimeve të shprehura jo vetëm nga OSBE-ja, por edhe përfaqësues të tjerë ndërkombëtarë”. Pasi projektligjet e ndryshuara u paraqitën pak javë më parë në Komisionin e Ligjeve, përfaqësuesi i OSBE-së për medien, Harlem Desir, i ka dorëzuar sot autoriteteve një

rishikim ligjor të tyre. Teksa vlerëson ndryshimet që janë bërë, ai rekomandon edhe nevojën për ndërhyrje të tjera.

Pra, numri një i medieve i OSBE-së në Vjenë, një figurë e pakontestueshme, me integritet të plotë, organizata më e madhe demokratike në botë me 57 shtete anëtarë, nuk thotë që është ligj fashist. Si guxon ai zotëria ta quajë të tillë? Çfarë mandati ka ai dhe kë përfaqëson ai? Ne përfaqësojmë diçka, sepse jemi votuar; qeveria përfaqëson diçka, se ka marrë një mandate; Harlemi përfaqëson shumëçka, 57 shtete, duke qenë numri një i medieve dhe nuk e thotë një gjë të tillë. Ne jemi gati këtu të diskutojmë, t'i marrim në konsideratë gjërat që nuk shkojnë, siç janë bërë disa përmirësime të bëjmë edhe tjera, por ende nuk e kemi shprehur mendimin tonë, edhe pse jemi shumë të shqetësuar dhe të përgjegjshëm sa i takon kësaj çështjeje.

Kush reagon kundër këtij ligji? Kundër këtij ligji reagojnë organizata dhe individë, të cilët janë në konflikt të pastër interesi, ata që kanë portale, por ne nuk jemi armiq me ta. Ne gjithmonë i kemi ftuar grupet e interesit, kemi diskutuar për ta dhe kemi gjetur shumë gjëra e përbashkëta, gjë që e kemi bërë prej kaq vitesh pozitivë dhe opozitivë. Kjo është një praktikë parlamentare, një edukatë dhe një kulturë, të cilën e kemi arritur deri tani. Si mund të vijmë këtu dhe të flasim me këtë gjuhë? Si nuk kam dëgjuar ndonjë që përfaqëson interesin e këtij grupi të thotë: “Nuk e kanë shqetësim këta që këto portale nuk pranojnë të regjistrohen? Pse nuk duan të regjistrohen?” Një ndër arsytet se pse ata nuk duan të regjistrohen është fakti se duan të mbrojnë punën e tyre në të zezë dhe gazetarëve që punojnë atje nuk u paguajnë siguracionet. Këta nuk janë të shqetësuar kur prodhohen lajme të tilla, si ai lajmi që nxori 300 mijë shqiptarë në rrugë dhe kushedi se sa njerëz janë sot të sëmurë me takikardi, një dëm moral dhe shëndetësor. Si ka mundësi që kjo gjë të mos vlejë?!

Ky projekt synon ta rregullojë këtë gjë. Do të thoni ju se pse nuk u morr asnjë lloj mase ndaj portalit që e publikoi? Nuk u morr asnjë lloj mase, sepse nuk ka asnjë rregullim ligjor. Kjo maxhorancë do të ishte tamam ashtu siç thuhet, në qoftë se pa rregullim ligjor, do të kishte bërë një ndërhyrje, pasi nuk mund të jemi të papërgjegjshëm ndaj një shqetësimi kaq të madh. Këto 700 portale, një pjesë e të cilave e bëjnë punën dhe një pjesë jo, për të rregjistruar gazetarët, për t'i mbrojtur ata, për të rritur sjelljen e tyre ndaj asaj që quhet respekt, dinjitet, gjuhë kundër urrejtjes, ligjit të privatësisë e shumë gjëra të tjera, ky ligj synon t'i vendosë në rregull. A ka diskutime? Sigurisht që ka diskutime. Edhe ne këtu pikërisht këtë gjë po bëjmë, po bëjmë diskutime për disa ndryshime që lidhen me masat e gjobave. Të thuash që ky ligj nuk e rrit dinjitetin e informimit të

publikut, që merr në mbrojtje gazetarët që paguhën në të zezë qenka ligj fashist, synon të vendosë disa rregulla që janë të diskutueshme në Shtetet e Bashkuara, sepse për shkak të këtyre portaleve të parregulluara me ligj në Shtetet e Bashkuara mendohet se është rrezikuar vota e një kombi të tërë që është kombi më demokratik në botë, atëherë ne e shpikëm këtë histori! Si mund të flitet në këtë mënyrë dhe të paragjykohemi të gjithë ne?! Si mundet që kjo çështje, e cila është shqetësim i të gjithë qytetarëve dhe i atyre që na kanë votuar dhe na kanë sjellë këtu të mos merret në konsideratë?! Është detyra jonë t'i mbrojmë ata!

Ne duhet t'i respektojmë grupet e interesit, por nuk mundemi të jemi në funksion të 10 individëve që u preken interesat dhe nuk duan të regjistrohen, që publikojnë reklama...

Fatjona Dhimitri – Këtu nuk preken interesat e 10 individëve, Musa, por preken interesat e medias së gjerë...

(Diskutime pa mikrofon.)

Po, jo, përdor koperturën...

(Diskutime pa mikrofon.)

O Milva, çfarë je duke thënë?

Musa Ulqini – Nuk e kam zakon të fyej njeri, por po ju them, e kam këtë të drejtë besoj, jam kaq shumë i çuditur se si interesat private i bëjnë individët që janë të mirëshkolluar, që njohin standardet dhe e dinë shumë se çfarë është demokraci, si funksion liria e medias dhe institucionet, në mënyrë të qëllimshme dhe vetëm për të mbrojtur interesat e tyre personale, nuk po them politike, të dezinformojnë në mënyrën më agresive. Kjo që sapo lexova këtu, së bashku me atë që tha zotëria, mendoj se e kanë bërë kastile, në mënyrë që të lexohet, sepse këtu nuk lexon askush. Po ju them se këtu ka disa njerëz që nuk e kishin lexuar fare projektin, sepse projekti nuk thotë që u mohohet e drejta atyre që i ndëshkon AMA apo Këshilli i Ankesave për të mos shkuar në gjykatë. Kjo është te neni 132 i ligjit ekzistues, por është edhe te ky ndryshimi që kemi në dorë, por kjo nuk është prekur. Cili është ndryshimi?

Në ligj thuhet që para se të ekzekutohet vendimi i AMA-s, shkohet në gjykatë. Këtu thuhet: ekzekutohet vendimi i AMA-s dhe i Këshillit të Ankesave dhe, më pas, shkohet në gjykatë. Le ta diskutojmë këtë gjë se sa demokratike apo jodemokratike, por nuk mund të flitet për diçka që është 100% e pavërtetë. A mund të ndodhë kjo në një shtet që është anëtar i NATO-s dhe që do të marrë drejtimin e OSBE-së, që t'u heqë të drejtën qytetarëve, një e drejtë bazë kushtetuese, për t'u ankuar ndaj çdo institucioni, kur ka një problem apo mosmarrëveshje? Të gjithë kemi të drejtë

të shkojmë në gjykatë, unë kur zihem me gruan, ai tjetri kur zihet me të vëllanë apo kur ai tjetri ka një problem pronësie; edhe nëse unë nuk jam dakord me kryetaren dhe kemi diçka madhore, shkojmë në gjykatë dhe e zgjidhim atje.

Atëherë, ne me këtë projekt po u heqim të drejtën qytetarëve të shkojnë në gjykatë?! Kjo është shumë e pavërtetë!

Në mbyllje dua t'ju them se ky projektligj ka ngjallur tensione për shumë arsye, për arsye politike, pasi është një rast për të sulmuar Kryeministrin e Shqipërisë, pasi është njeriu që e ka ideuar atë për shkak të këtij realiteti. Unë nuk dua të futem në këtë lloj diskursi, sepse lufta politike, edhe kur ka tejkalime, siç është ky rast, është diçka që ndodh në Shqipëri. Por që të ndodhë për interesa personale dhe të arrihet në gjëra kaq të pavërteta, unë, si përfaqësues i popullit nuk mund ta pranoj.

Askush nuk ka të drejtë. Pavarësisht se nga kemi ardhur, të gjithë përfaqësojmë diçka. Secili nga kolegët që kam përballë, që nga kryetarja e komisionit e deri tek ai zotëria në fund, janë futur në listat e partive politike jofituese për një arsye, sepse në komunitetet ku ata jetojnë, të vogla apo mëdha, rurale apo qytetare, në Jug apo në Veri, përfaqësojnë diçka, prandaj janë futur atje.

Si mund të flitet me këtë gjuhë ndaj kolegëve? Ne mund të pranojmë gjithçka, por jo këtë...

Fatjona Dhimitri – Të lutem, Musa, po e kaloni rendin e ditës!

Musa Ulqini – Sot në këtë komision ka ndodhur diçka, e cila nuk ka ndodhur kurrë më parë, që nga viti 1992, kur këtë komision e kryesonte Uran Butka, një përfaqësues i shquar i së djathtës së vërtetë, të fliten gjëra kaq të pavërteta, ku të ftuarit të fyejnë deputetët dhe të mos respektohen normat bazë elementare... Unë do të refuzoja ta dërgoja djalin apo vajzën time në një fakultet, ku drejtues të gazetarisë janë njerëz të tillë, që nuk respektojnë gjërat më elementare dhe me një karshillëk të paparë i thonë këto përpara medieve...

Fatjona Dhimitri – Musa, refuzoni ligjin, mjaft me këto budallallëqe.

(Diskutime pa mikrofon.)

Interesi i vetëm politik që cenohet këtu është interesi i Kryeministrit tuaj, sepse kërkon që vetëm propaganda dhe sloganet e tij të përhapen nëpër media dhe për këtë arsye vendos censurën ndaj medias me këtë ligj.

Mjaft më!

Vazhdojmë me përfaqësuesit e Fakultetit të Drejtësisë.

Fjalën e ka zoti Ilir Puta.

Ilir Puta – Faleminderit për ftesën, zonja kryetare!

Në radhë të parë, dëshiroj të theksoj se kam ardhur si specialist i të Drejtës Administrative Kushtetuese të Fakultetit të Drejtësisë dhe jo për të bërë ndonjë *show* personal apo për të dhënë gjykime politike. Nëse ne, si pedagogë, thirrëmi për fushat e ekspertizës, duhet t'i përmbahemi përmbajtjes së ligjit. Pas analizës dhe leximit të plotë të ligjit dhe duke krahasuar parashikimet e projektligjit me dispozitat kushtetuese, Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut dhe aktet e tjera ndërkombëtare dhe kombëtare, kam arritur në disa konkluzione.

Në radhë të parë, kemi të bëjmë me plotësimin e legjislacionit në një fushë që nuk është rregulluar më përpara; kjo është një situatë normale dhe është detyrë e Kuvendit dhe e ekzekutivit qendror të plotësojë legjislacionin në një fushë të parregulluar. Gjithashtu, ky plotësim ligjor rregullon një diferencim midis kategorisë së medieeve tradicionale, të cilat ishin të rregulluara ligjërisht, me një kategori tjetër të medieeve që nuk janë rregulluar më parë ligjërisht. Pra, kemi plotësimin e dy kategorive të medieeve, që nuk mund të trajtohen në mënyrë të diferencuar.

Nëse ka kufizime të veprimtarisë së medieeve tradicionale, siç janë radio dhe televizioni, që ne i njohim, natyrisht, këto lloj kufizimesh duhet të veprojnë në të njëjtën masë dhe mënyrë edhe për llojet e tjera të medieeve alternative që janë krijuar gjatë kohës. Ky është një problem thelbësor, sepse kemi përballjen e dy apo më shumë të drejtave themelore: nga njëra anë, kemi kategorinë e të drejtës dhe lirisë së medias, së shtypit, të informimit dhe të fjalës së lirë dhe, nga ana tjetër, kemi përballjen me kategorinë e të drejtave të tjera, duke filluar që nga mbrojtja e dinjitetit dhe personalitetit të njeriut, të jetës private, të rendit publik e me radhë. Janë një sërë kategorish të drejtash që përballen në këtë projektligj me njëra-tjetrën. Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut dhe Jurisprudenca e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut në Strasburg, si dhe Gjykata jonë Kushtetuese, që ka një jurisprudencë të gjerë në këtë fushë, janë të mbushura me raste ku janë dashur të përballen këto kategori të drejtash dhe tashmë kemi një jurisprudencë të konsoliduar në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, për të matur nivelin e kufizimit të të drejtave. Në nenin 17 të Kushtetutës thuhet: “Kufizimi i të drejtave parashikohet në masën e diktuar nga situata dhe matet në analizë nga një sërë faktorësh shoqërorë, politikë, ekonomikë e të tjera me radhë”.

Natyrisht, nuk është e lehtë të vlerësohet se cila është masa e kufizimit e një niveli me një tjetër, megjithatë duhet të themi që këto nivele të kufizimit i kemi të përcaktuara tashmë në nivel

ndërkombëtar, duke filluar me Gjykatën e Strasburgut e me radhë. Nuk mundemi ne apo Kuvendi të krijojmë nivele të tjera të kufizimit, përtej asaj që vetë Kushtetuta lejon, sipas jurisprudencës së Gjykatës së Strasburgut.

Nga ana tjetër, dua të theksoj që të drejtat e njeriut janë të barabarta ndërmjet tyre. Nuk mund të themi që e një e drejtë e njeriut është më e rëndësishme dhe një tjetër është më pak e rëndësishme. Duke përjashtuar të drejtën e jetës, të drejtat e tjera, si personaliteti i njeriut janë njëlloj si e drejta e fjalës dhe e shtypit apo ruajtja e rendit publik, siguria kombëtare e të tjera me radhë. Ne nuk mund të themi që këto janë më të bukura, më të mira apo më të rëndësishme për ne, ndërsa të tjerat t'i anashkalojmë dhe të mos i respektojmë, por në të njëjtin nivel ama. Është e vërtetë që për shkak të eksperiencës si një vend totalitar, ne kemi pasur si preokupim kryesor mbrojtjen e disa të drejtave të para themelore që janë krijuar, siç është edhe e drejta e fjalës dhe e medieve, por natyrisht edhe të drejtat e brezit të tretë, që quhen standardet bazë të funksionimit të shoqërive europiane. Dallimi bazë midis një shoqërie europiane dhe një shoqërie në fazë tranzicioni, që nuk kanë pasur një konsolidim demokratik është pikërisht fakti që quhen të drejtat e brezit të tretë, si: mbrojtja e jetës private, dinjitetit dhe personalitetit të njeriut, që nuk respektohen njësoj si ato të brezit të parë, apo që kanë lindur më parë në historinë e njerëzimit. Faktikisht, kjo bën diferencën e mënyrës së funksionimit të shoqërisë dhe jetesës së vetë individëve, kështu që do të doja të theksoja faktin që kur mbrohen këto të drejta, duhen trajtuar në mënyrë të barabartë, kështu që edhe kufizimi reciprok mes tyre duhet parë në mënyrë të barabartë.

Gjithashtu, duke iu referuar sistemit gjyqësor në fuqi, doja të vija në dukje që gjykatat tona për çështjet e kufizimit të lirisë së shprehjes, kanë marrë një sërë vendimesh, ku kanë sanksionuar çdo subjekt që ka abuzuar me lirinë e shprehjes dhe mendimit, dhe kjo është një praktikë e konsoliduar tashmë prej dekadash. Faktikisht, parashikimet e ligjit janë më të buta sesa ato vendime gjykatash që kemi parë deri tani. Nuk kam ardhur këtu të analizoj vendimet e gjykatave, por dua të them se ky realitet i kufizimit të të drejtave ekziston vërtet.

Nga ana tjetër, në këtë rast kemi një organ administrativ, i cili do të ketë të drejtë në mënyrë paraprake që të marrë masa për të vendosur një kufizim të të drejtës dhe lirisë themelore të shprehjes dhe, natyrisht, gjykata në raport me një organ administrativ ka një tagër, pavarësi dhe garanci shumë herë më të lartë sesa organi administrativ. Ky është një parim i përgjithshëm i së drejtës, ku gjykatësi është garant shumë herë më i mirë se një organ administrativ.

Në kuadër të projektligjit kam dy sugjerime: Këshilli i Ankesave, në momentin e shqyrtimit të ankesave, ka të bëjë me rastet e kufizimit të lirisë së të drejtës së shprehjes, duhet të ketë një sistem standardesh të ligjëruara në kuptimin e një tërësie rregullash standarde që nxirren nga gjithë jurisprudenca e Gjykatës sonë Kushtetuese dhe Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut, duhet të jetë në formën e një akti nënligjor normativ, udhëzim apo akt i brendshëm i nxjerrë nga AMA, ku, në momentin e vendimmarrjes, të gjitha këto standarde të jenë të shkruara dhe shprehura qartësisht, në mënyrë që kur të marrë vendimin Këshilli i Ankesave, të jetë në përputhje me këto standarde që i ka elaboruar me kohë Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut, por edhe Gjykata jonë Kushtetuese është shumë e gjerë në këtë fushë.

Gjithashtu, kisha një sugjerim në nenin 51, pika 1, që shtohet, ku parashikohet që Këshilli i Ankesave ka të drejtë të zgjedhë nëse duhet të njoftojë Operatorin e Shpërndarjes së Informacionit në publik në rastin e një ankese kundrejt tij, duke iu referuar edhe Kodit tonë të Procedurave Administrative, parimit të procesit të rregullt ligjor edhe brenda procesit administrativ. Organi administrativ është i detyruar të njoftojë në rastin kur ka hapur një procedim administrative, ku ka çdo palë të interesuar. Kështu që duhet ta njoftojë, jo të zgjedhë nëse duhet ta njoftojë apo jo.

Neni 51/1, që shtohet si nen i plotë...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Është shtuar si nen, por parashikon në pikën 6 që...

“Duhet të marrë pjesë në procedim administrativ” duhet të njoftojë. Në qoftë se nuk është regjistruar tek AMA, në qoftë se adresa e dhënë është e pasaktë e me radhë, mbulon detyrimin për një proces njoftimi të rregullt administrativ, pra quhet i konsideruar njoftimi, bëhet dhe njoftim publik *online* në faqen e AMA-s për këtë rast, por duhet të marrë pjesë në këtë vendimmarrje, të njoftohet dhe t’u jepet një afat 2-3 ditor sa është aty, që të japin opinionin e vetë dhe në fund fare të merret vendimi.

Ju falënderoj!

Orjona Muçollari – Përsëritje të gjithëve!

Jam zëvendësdekane e Fakultetit të Drejtësisë, gjithashtu pedagoge e të Drejtave të Njeriut.

Për hir të së vërtetës, ligji në vetvete dhe ndryshimet e tij më së shumti prekin dhe cenojnë të drejtat e njeriut. Kështu që në këtë pikë, pa dyshim, debati është më sensitiv dhe në një farë mase është e vështirë për të vendosur një balancë. Të gjitha instrumentet ndërkombëtare, qoftë ato

rajonale, siç është rasti i Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut, së bashku me Gjykatën Europiane të të Drejtave të Njeriut, por më së shumti instrumentet e Kombeve të Bashkuara, gjithashtu, në rang universal, theksojnë me të madhe që vendosja e një rregullimi apo një standardi, duke vazhduar edhe konkluzionet e kolegut tim, për të arritur një balancë më të mirë midis këtyre dy të drejtave kaq të rëndësishme, asaj të lirisë së shprehjes nga njëra anë, dhe të drejtës për jetën private, për sigurinë e shtetit e të gjitha me radhë, duhet të kenë një kuadër proporcionaliteti.

Gjithashtu, theksoj se është e rëndësishme që ky ndryshim duhet të vinte për ta rritur dhe rregulluar situatën e medias *online*, e cila ka nevojë për një rregullim, të gjithë e dimë këtë. Ajo për të cilën instrumentet ndërkombëtare dhe sidomos mekanizmat japin raporte, vendime gjyqësore, si në rastin e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut është, për këtë do të doja të tërhiqja vëmendjen dhe të jepja një sugjerim, pa diskutim duhet të ketë një dallim, sepse nuk mbajnë të njëjtën përgjegjësi media klasike, media e shkruar me medien *online*. Te rasti i medias *online* ndryshojnë, që do të thotë se përdoruesit kanë një detyrueshmëri dhe sanksion ndryshe dhe pronarët e këtyre faqeve kanë një lloj mekanizmi kontrollues ndaj tyre dhe bëhen përgjegjës më pas, për mosbllokimin e tyre e të tjera me radhë.

Në këtë aspekt kam përshtypjen që ky draft vjen në momentin e duhur, sepse ne e kemi parë çfarë ka ndodhur me komunikimin totalisht të pakontrolluar *online*, ndaj mendoj se ka nevojë për një lloj balancimi proporcionaliteti dhe ndarjeje midis të dyjave, midis medias së shkruar klasike dhe asaj *online*. Në përgjithësi, të dyja ndryshojnë, sidomos te përgjegjësitë që mbajnë pronarët apo përdoruesit kryesorë të këtyre faqeve.

Ju faleminderit!

Fatjona Dhimitri – Faleminderit, zonja Muçollari!

Pra, ju e shihni ligjin kushtetues nën frymën kushtetuese?

Orjona Muçollari – Sikundër ju thashë, ka nevojë për të bërë ndryshime dhe rregullime për median *online*, jam e sigurt që të gjithë biem dakord për këtë. Ndërsa për sa i përket draftit të ardhur, që kemi në tavolinë, mendoj se ka nevojë për një rregullim për të caktuar dhe për të parë se si janë përgjegjësitë deri në fund të medias *online* dhe asaj klasike.

Fatjona Dhimitri – Faleminderit!

Fjala për përfaqësuesit e Universitetit të Durrësit.

Lorena Liçenji - Përshëndetje!

Ju falënderojmë për ftesën!

Duke parë të gjithë draftin dhe duke njohur edhe fushën e komunikimit, do të doja të shprehesh përmblendhtazi vetëm në disa pika, duke konsideruar edhe kohën e limituar në dispozicion.

Jemi të gjithë në dijeni që mediat e reja dhe ato *online* e kanë zgjeruar së tepërmi hapësirën e lirisë së shprehjes së të gjithë individëve dhe në përgjithësi edhe për marrjen e informacionit nga publiku. Normalisht, kjo liri vjen edhe me gjuhën e urrejtjes, sikurse po e shohim, me lajmet e rreme dhe me dhunimin e privatësisë.

Ne do të sugjeronim, në bashkëpunim edhe me kolegët, që të ndërmerren nisma vetërregulluese në mënyrë specifike nga mediet *online*. Shohim që një pjesë e mirë e medieve *online* i kanë ndërmarrë nismat vetërregulluese, duke nënkuptuar Kodin e Etikës dhe të Sjelljes, por duhet të bëjë më shumë presion në vetërregullimin dhe respektimin e këtyre kodeve.

Do të sugjeroja një vetërregullim për të krijuar një ambient mediatik, që të jetë të paktën etik në respektim të të drejtave të lirisë së shprehjes dhe të drejtave të individit për t'u informuar.

Kjo ishte pika e parë, ku do të doja të vendosja theksin.

E dyta, ngritja e mekanizmave vetërregullues, sikurse edhe kolegët vendosën theksin, mendoj se do të ndihmojë për të pasur sjellje korrekte dhe etike. Këto sjellje korrekte nga ana e gazetarit, në gjykimin tonë, do të ndihmonin në mënyrë të ekuilibruar edhe për rritjen e besueshmërisë së këtyre portaleve dhe medies *online*, por, nga ana tjetër, do të ndihmonte edhe qytetarin në marrjen e një informacioni cilësor.

Ajo që na intereson sot është që qytetarët të marrin informacion cilësor, të verifikuar dhe të kontrolluar, por, nga ana tjetër, duhet të kemi kujdes në cenimin e lirisë së shprehjes së gazetarëve.

Pika e tretë, të mbrohet pavarësia e medies në mënyrë specifike nga kompetencat sanksionuese që, me sa pamë, projektligji i parashikon, në lidhje me gjobat. Në gjykimin e komisionit të rishikohet edhe niveli i gjobave në varësi të audiencës.

Pika e fundit, ku do të doja të vendosja theksin, lidhet me mediet klasike dhe tradicionale, por edhe me mediat e reja. Shohim që interneti me kalimin e kohës po ndikon në kultivimin e lirisë së shprehjes. Duhet parë që kemi aspekte pozitive, secili ka hapësirën për të shprehur opinionin dhe gjykimin e vet, normalisht duhet të ketë edhe aspekte negative që duhen marrë parasysh.

Domosdoshmërisht mendojmë se ka nevojë për ligjshmëri, pra nuk është një sektor që nuk do të duhet të rregullohet, por do të sugjeronim që të kihet parasysh që ajo që na shqetëson

është një ligjshmëri e tepruar, e cila mund të kufizojë në një farë mënyre misionin parësor të internetit, që është informimi dhe përdorimi i një kanali komunikimi në mënyrë të lirë nga të gjithë.

Këto ishin pikat kryesore dhe shpresoj se do të jenë sugjerime të vlefshme për punën tuaj.
Faleminderit!

Fatjona Dhimitri – Faleminderit!

Fjala për përfaqësuesit e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja.

Drita Rira - Mirëdita të gjithëve!

Është hera e parë që marr pjesë në komisionet parlamentare dhe ju falënderoj për ftesën!

Do të flas në cilësinë e një qytetareje, sepse nuk pretendoj të mbuloj atributet e një juristi. U bashkohem mendimeve që ata dhanë, të cilat i gjej shumë të vyera, por në debatin e madh që mund të ekzistojë për konceptin e lirisë dhe demokracisë, mendoj se liria duhet të prevalojë mbi demokracinë. Kur flitet për të drejtat dhe lirinë, gjëja që më vjen ndër mend është prevalimi i të drejtave, por, nga ana tjetër, anashkalohet deri diku detyrimi. Çdo e drejtë ka edhe një detyrim nga pas dhe në këtë lloj detyrimi mendoj se për të respektuar ose për t'i shkuar më pranë qytetarit, do të ishte e nevojshme të gjendej një lloj ekuilibri mes së drejtës për të informuar dhe, nga ana tjetër, të ruajtjes së dinjitetit dhe privatësisë. Mendoj se në dobi të qytetarit më shumë sesa fushat e interesit, është që të rimarrë edhe një herë informim sa më cilësor.

Kaq kisha. Nuk mund të shprehem për projektligjin, nëse është i duhuri apo jo.

Faleminderit!

Musa Ulqini - Faleminderit, zonja kryetare!

Kam një pyetje për profesoreshën nga Durrësi: është një diskutim që është bërë nga të gjithë përfaqësuesit që kanë marrë pjesë në komision, por unë marr pjesë në tavolina të ngjashme, ku shtrohet çështja e vetërregullimit. Vetërregullimi do të ishte një mrekulli, në qoftë se do të kishte ndodhur në Shqipëri në këta 30 vjet. Në kuadër të këtij diskutimi, disa parafolës dje dhe pardje, thanë që ligjvënësit le ta marrin nismën për vetërregullim dhe ne do ta mbështesim.

Pyetja ime është: si e mendoni ju vetërregullimin, duke pasur parasysh atë që ka ndodhur deri tani? Kush duhet ta bëjë këtë? Ne kemi një Kod Etike që e keni në tryezën tuaj, nga më të mirët, por nuk ka një institucion përgjegjës që ta zbatojë, që të përfaqësojë komunitetin e gazetarëve, i vetërregulluar dhe i ngritur nga vetë ata. Kanë dështuar deri më sot të gjitha përpjekjet për të krijuar një institucion të tillë. Ne nuk kemi një institucion të tillë. Kush duhet ta bëjë këtë? Ta bëjmë ne ligjvënësit?

Kam qenë në këtë komision në vitin 2000 kur REX-i, një institucion amerikan në bashkëpunim me Institutin e Studimeve Politike Publike dhe me komisionin tonë, bëmë një projektligj të quajtur “Akti i lirisë së shtypit”. Në nenin 1 të tij thuhej: “Objekti i ligjit është i tillë që mbron gazetarët nga pronarët, nga shteti dhe ndërton një raport të drejtë me qytetarët” dhe krijuam Urdhrin e Gazetarit, model i ngjashëm me Italinë. Kaq bënte ligji dhe vetë gazetarët pastaj, në bazë të këtij ligji, ngrinin institucionet, regjistroheshin, zgjidheshin ekipet dhe mblidheshin për të mbajtur qëndrime ose bëheshin garant të Kodit të Etikës. Kam qenë në këtë komision, në zyrën ku Enveri bënte ato dënime të famshme, ku ftuam përfaqësuesit e medieve. Ata që kanë 3 ditë që na tregojnë me gisht, ishin kundërshtarët më të egër të kësaj nisme, sepse na u tha që ju, shteti, maxhoranca, ligjvënësit po ndërhyjnë aty ku nuk keni tagër. Ne, si ligjvënës, bëmë vetëm këtë gjë, krijuam shtratin juridik dhe gjithë mirëfunksionimi i këtij institucioni rregullues nuk kishte lidhje me politikën. Pra, është bërë një gjë e tillë dhe ka dështuar me sukses të plotë. Ne u tërhoqëm, për shkak se nuk kishim këtë situatë që kemi sot, sepse media krijon një opinion. Mediet kanë fuqi. Ato përdorin punën e tyre dhe kanë një ndikim të madh në publik. Ishin pronarë mediesh ata. Unë nuk kam dëgjuar gazetarë që të flasin për instrumentet vetërregulluese, sepse e them gjithmonë që vetëm në Shqipëri ndodh që gazetarët bëjnë protesta që t’u shtohen benefitet pronarëve. Ne nuk kemi një sindikatë gazetarësh, si në Greqi, për shembull, që një herë në vit mblidhen atje me përfaqësuesit e Komisionit Kombëtar të Punës, se nuk ia di saktë termin, ndërsa këtu janë përfaqësuesit e qeverisë, përfaqësuesit punëdhënës privatë. Gazetarët duhet të bëjnë një marrëveshje çdo vit në terma konkretë, por ne nuk e kemi këtë përvojë, sepse nuk ekziston ky institucion. Nuk është ky rasti, në fakt.

Profesoreshë, ju lutem, në bazë të përvojës dhe diskutimit që bëtë, keni ndonjë sugjerim, sepse e kam dëgjuar kaq shumë që duhet dhe nuk është bërë tash 30 vjet? Kur kemi tentuar ta bëjmë, jemi akuzuar më shumë sesa sot. Si mund të zgjidhet kjo çështje?

Lorena Liçenji - Ju falënderoj!

Lidhur me mënyrën se si funksionon media tradicionale, kemi parasysh faktin që ekziston Kodi i Etikës dhe i Sjelljes, për të qenë realist, jemi të gjithë konsumatorë të medies, këto kode nuk aplikohen totalisht dhe me to ka pasur probleme. Të njëjtat probleme shfaqen edhe te mediet e reja.

Sugjerimi është që duhet parë në kuadër të interesit të vetë gazetarëve, mbase po e shoh në aspektin teorik, të atyre profesionistëve të medies, që të insistojnë të paktën të nisin provat për

krijimin e mekanizmave vetërregullues. Nuk duhet ta shohin si një masë shtrënguese, por si një rritje të cilësisë së punës së tyre. Ne në këtë këndvështrim e shohim. Pra, në qoftë se do të krijohen mekanizma vetërregullues, Kode Sjelljeje, Kode Etike, normalisht do të rritet cilësia e punës së gazetarit. Rritja e cilësisë së punës së gazetarit çon në rritjen e nivelit të besueshmërisë, pra nuk do të arrijmë në vendosjen e gjobave apo në marrjen e masave ndëshkuese.

Kështu që duhet të lindë iniciativa nga vetë portalet dhe mediet e reja. Kjo është tentativa e parë në gjykimin tim.

Faleminderit!

Fatjona Dhimitri – Faleminderit!

Të nderuar të ftuar,

Ju falënderoj për pjesëmarrjen tuaj sot! Do t'ju lutesha që të gjitha sugjerimet tuaja t'i depozitoni pranë shërbimeve të komisionit tonë.

(Të ftuarit largohen.)

Milva Ekonomi – E dini pse e kërkoja këtë pushim mes mbledhjes, kolegë? Kryetare, ne nuk mund ta pranojmë më këtë sjellje nga ana juaj! Është e patolerueshme! Unë e kuptoj shumë mirë qëllimin që mund të keni për profesorët që keni thirrur këtu, e kuptoj edhe angazhimin që keni për t'i mbrojtur, por të bëni këtë sjellje në komision, me anëtarët e komisionit, është e patolerueshme!

Lidhur me atë që thoni, merrni dhe lexoni një për një Rregulloren...

Fatjona Dhimitri – E njoh shumë mirë Rregulloren! Kërkoj që edhe të ftuarit aty të respektohen!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Çfarë ke, Mirela?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Milva Ekonomi – Ne duhet të bëjmë një kërkesë për t'ju hequr si kryetare e këtij komisioni, dhe e kam seriozisht, sepse kjo sjellje është e patolerueshme. Nuk mund të përçudnohen në këtë formë kolegët deputetë! Nuk e kupton fare rëndësinë që ka kjo karrige, nuk kupton as rëndësinë që ka Rregullorja!

Nuk e di nëse bini dakord apo jo, kolegë, por unë jam gati që të hartojmë që tani një letër, që t'ia kalojmë Konferencës së Kryetarëve dhe Kryesisë së Kuvendit. Fatjona nuk mund të jetë më kryetare e këtij komisioni!

(Largohet kryetarja e Komisionit.)

(Mbledhja vijon pa prezencën e gazetarëve.)

Mirela Kumbaro - Në radhë të parë, kërkoj ndjesë për tonin që s'ka të bëjë me mua, por ka të bëjë me një shkelje të përsëritur të etikës nga zonja kryetare, por nuk e tërheq aspak atë që thashë!

Ndërkohë që nënkryetarja e komisionit merr fjalën, nuk arrin dot të shkojë te fjalja e dytë, se i ndërpritet fjala. Është e tmerrshme që në Komisionin e Medias, ku flitet për komunikimin, të drejtat e njeriut, edukimin, kulturën e të gjitha gjërat e bukura që kemi në fushën tonë të kompetencës, të mos arrijmë prej dy vjetësh të respektojmë minimalisht etikisht njëri-tjetrin! E para kjo.

E dyta, në mënyrë të përsëritur në seancë me dëgjuesit, nuk respektohet rregulli numër një i Rregullores për veprimtarinë e komisioneve parlamentare, që, kur kërkohet fjala për procedurë, duhet të jepet.

E treta, këtu vijmë në nocionin që mund të jetë edhe relativ, por unë besoj që rregullat etike, janë rregulla të vendosura me konvencion në një shoqëri dhe të gjithëpranuara si të tilla, që të quhen “të sjellshme, të pasjellshme, rrugaçerore e të tjera” dhe sot, ndjesë, por në komisionin tone, fjala mund të jetë e rëndë, pati sjellje rrugaçerore. Përveçse ne të gjithë kemi për detyrë të ruajmë etikën e komunikimit në komision, në radhë të parë, por edhe etikën e sjelljes ndaj kolegëve dhe ndaj të ftuarve, këtë gjë, në radhë të parë, duhet ta bëjë kryetari i komisionit, që jo vetëm nuk e bëri, por e nxiti, e përforcoi duke u bërë palë me një sjellje që sërish do ta quaj rrugaçerore, që shkaktoi dhe daljen time demonstrative nga salla dhe që, për fat të keq, vazhdoi. Këtu nuk ka të bëjë fare pakicë-maxhorancë, opozitë-pozitë, këtu kemi, në radhë të parë, qytetarë...

Milva Ekonomi – Nuk ndoqe edhe pjesën e dytë sesa keq u sollën me deputetët në përgjithësi në këtë komision dhe veçanërisht me deputetët e opozitës. Ishte skandal sjellja e tyre! Nuk e kishim dëgjuar ndonjëherë këtë sjellje, ku kryetarja u bë palë me ta. Ky është një gjest i paparë ndonjëherë. Asnjëherë nuk ka ndodhur një rast i tillë në komision. Kjo është arsyeja që ne do të marrim këtë iniciativë për t'u drejtuar pranë Kryesisë së Kuvendit, që të kërkojmë largimin e kryetares.

Mirela Kumbaro - Ne ia ruajmë fytyrën kryetares, sepse kështu dimë të sillemi, as nuk e fyejmë, madje kritikën përpiqemi të mos ia bëjmë publikisht, sepse besoj që figura e kryetarit të komisionit është shumë e rëndësishme. Është hera e dytë, brenda dy ditëve, që në momentin që ne

bëjmë debat të brendshëm lidhur me përmirësimin e kushteve të punës së komisionit, kryetarja largohet.

Kam vetëm një shpjegim: dobësi totale dhe paaftësi për të përballuar debatin e brendshëm mes nesh, mungesë argumenti për të diskutuar dhe justifikuar pozicionin dhe sjelljen e saj. Domethënë, unë, përveçse paaftësi, për të mos thënë ndonjë gjë tjetër, nuk shoh...

Pastaj njeriu ikën nga tavolina e debatit, se ne nuk fyejmë.

Unë u largova në mënyrë demonstrative, sepse nuk pranoj të jem në një tavolinë, në një sallë me njerëz që i kemi ftuar ne dhe që të fyejnë pa pikën e turpit.

Në kushte të tilla, unë bashkohem totalisht me propozimin e nënkryetares që të hartojmë një kërkesë për paaftësi të zonjës për ta drejtuar këtë komision, që meriton më shumë se kaq.

Bujar Çela – Nga të gjitha këto që kemi bërë dje, sot dhe herë të tjera, unë jam bindur se ky projektligj e këto ndryshime kanë ardhur në kohën e duhur dhe janë të domosdoshme.

Ne nuk duhet të çuditemi nga sjellja e “Vokshit nr. 2”, sepse po dëgjojmë shokët e saj që ia kanë dhënë në përdorim kësaj tjetres.

Ata, edhe dje kanë abuzuar pafundësisht edhe me organizmat ndërkombëtarë, të cilëve u referoheshin, në një kohë kur ata ishin vetë dhe bënë po ato vërejtje që ne kemi përmirësuar në draftin e ribërë, dhe jemi duke përmirësuar nga dëgjesat që kemi bërë. Sikurse e përmendi edhe relatori, i cili sot bëri rolin e duhur, por duhej ta kishte marrë më përpara, edhe dje ishte e domosdoshme kjo mënyrë komunikimi. Këtu ishin ata pronarë mediesh, të cilët thërrasin ekspertë të të gjitha fushave, por në fund konkluzionet i nxjerrin vetë, si “rakipët” me shokë.

Fyerja që ndodhi sot ndaj kolegut tonë dhe ndaj kolegëve në përgjithësi, nuk jam duke i marrë në mbrojtje në mënyrë politike, por qytetare, ishte fort e rëndë.

Shpërthimi, ikja e Mirelës, iku me delikatesë, por, në fakt, la llogoren bosh. Ndaj, unë them se ky projektligj duhet t’i nxitojë hapat, ta votojmë atë duke e përmirësuar në këto orët e mbetura, sot dhe nesër. Ata janë të interesuar për të ardhur te komisioni ynë dhe vijnë të gjithë, se ne jemi komision përgjegjës dhe jemi një komision që e kemi një “Vokshi” tjetër, e cila flet sikur është ajo, por shkruan dhe komunikon në mënyrë të përhershme me ish-deputetët e kësaj opozite.

Faleminderit!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Milva Ekonomi – Atëherë, e mbyllim për tani.

Kalojmë te marrëveshja e për “*Fulbright*”.

Ariana, nuk e di, do ta ftosh ose jo, do të pranojë të vijë kryetarja e komisionit, sepse e la mbledhjen. Në mos, ta bëjmë vetë pastaj, se edhe kuorumi është i plotësuar, pra e bëjmë ne që jemi këtu.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Mbyllet pika e parë e rendit të ditës



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

PROCESVERBAL

Tiranë, më 12.12.2019, ora 12:00

Drejton mbledhjen:

Fatjona Dhimitri – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

2. Diskutimi i projektligjit “Për ratifikimin e memorandumit të mirëkuptimit ndërmjet qeverisë së Republikës së Shqipërisë, Këshilli i Ministrave, dhe qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës për programin e shkëmbimit akademik “*Fulbright*”.

Marrin pjesë:

Fatjona Dhimitri, Milva Ekonomi, Fidel Ylli, Ramazan Gjuzi, Musa Ulqini, Vilma Bello, Ismet Beqiraj, Fadil Nasufi, Adelina Rista, Bujar Çela, Almira Xhembulla, Lindita Nikolla, Mirela Kumbaro, Kostaq Papa, Klajdi Qama, Selami Jenishehri, Erion Piciri.

Mungojnë:

Enada Kapllani, Amra Barova.

Të ftuar:

Konstandin Shkurti – Zëvendësministër i Arsimit, Sportit dhe Rinisë,

Erzen Tola – drejtor i Përgjithshëm Rregullator dhe i Përputhshmërisë për Arsimin, Sportin dhe Rininë në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë,

Vijon pika e dytë e rendit të ditës

Milva Ekonomi – Kalojmë te pika tjetër e rendit të ditës: diskutimi i projektligjit “Për ratifikimin e memorandumit të mirëkuptimit ndërmjet qeverisë së Republikës së Shqipërisë, Këshilli i Ministrave, dhe qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës për programin e shkëmbimit akademik “*Fulbright*””.

(Drejtimin e mbledhjes e merr zonja Dhimitri.)

Fatjona Dhimitri – Përshëndetje,

Në pikën e dytë të rendit të ditës për sot kemi shqyrtimin e projektligjit “Për ratifikimin e memorandumit të mirëkuptimit ndërmjet qeverisë së Republikës së Shqipërisë, Këshilli i Ministrave, dhe qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës për programin e shkëmbimit akademik “*Fulbright*”.

Të pranishëm kemi zotin Kostandin Shkurti, zëvendësministër i Arsimit, Rinisë dhe Sporteve; zotin Erzen Tole, Drejtor i Përgjithshëm Rregullator dhe i Përputhshmërisë për Arsimin, Sportin dhe Rininë.

Ju lutem, fjala për ju, zoti Shkurti.

Konstandin Shkurti – Ky projektligj ka për qëllim ratifikimin e memorandumit të mirëkuptimit ndërmjet qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, për programin e shkëmbimit akademik “*Fulbright*”.

Ky memorandum mirëkuptimi synon nxitjen e mirëkuptimit e të miqësisë ndërmjet dy kombeve tona, nëpërmjet programit të shkëmbimit akademik “*Fulbright*”, në institucionet arsimore, shkencore dhe kërkimore në të dyja vendet nënshkruese të memorandumit të mirëkuptimit.

Ky memorandum mirëkuptimi vjen si iniciativë e Ambasadës së Shteteve të Bashkuara në Tiranë, që ka filluar në fund të vitit 2000 (me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, sipas emërimit të kohës) dhe u rishikua në vitet 2016-2017.

Programi “*Fulbright*” u themelua në vitin 1945 dhe mbështet shkëmbimet arsimore që forcojnë mirëkuptimin dhe komunikimin mes Shteteve të Bashkuara dhe mbi 155 vende në mbarë botën dhe është një formë efektive e prestigjioze e diplomacisë publike.

Programi “*Fulbright*” për studentët e huaj është një program një ose dyvjeçar për profesionistë të rinj dhe ata që kanë përfunduar studimet, të interesuar të ndjekin studime në nivelin “Master” në Shtetet e Bashkuara.

Koordinatori i këtij memorandumi mirëkuptimi, në emër të qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, do të jetë Seksioni i Punëve Publike të Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Tiranë dhe në emër të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë do të jetë Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

Me anë të këtij memorandumi mirëkuptimi synohet që çdo vit të përzgjidhen studentë, personel akademik dhe profesionistë nga institucionet e arsimit të lartë dhe institucionet e tjera të Republikës së Shqipërisë për të studiuar në universitetet e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, si dhe të koordinohet dërgimi i studentëve, personelit akademik dhe profesionistëve të Shteteve të Bashkuara të Amerikës në institucionet akademike apo institucionet e tjera të Republikës së Shqipërisë për studime, kërkime apo stazhe akademike.

Pala shqiptare do të ofrojë mbështetje financiare në shumën prej 150 000 eurove në vit, nëpërmjet fondit të bursave të ekselencës, për të mbështetur kostot e programit “*Fulbright Student*”, me qëllim krijimin e më shumë mundësive për ata që do të marrin pjesë në këtë program. Kontributi do të paguhet duke filluar nga viti akademik 2019-2020 deri në vitin akademik 2024-2025, ndërsa pranimi do të fillojë nga viti akademik 2020-2021 dhe në vijim.

Institucionet tona qeveritare, arsimore, kulturore dhe kërkimore-shkencore, do të mundësojmë kushtet më të favorshme të mundshme për zbatimin e programit “*Fulbright*”.

Gjithashtu, pala shqiptare synon të koordinojë miratimin në kohën e duhur dhe lëshimin e dokumenteve ligjore të nevojshme për studentët, personelin akademik dhe për profesionistët pjesëmarrës në programin “*Fulbright*”.

Kjo marrëveshje është nënshkruar për një afat kohor pesëvjeçar, i cili mund të ndërpritet në çdo moment nga secila palë, por duke nënshkruar dhe me shkrim të japë arsyet e nevojshme pse ndodh kjo ndërprerje. Afati kohor është dymbëdhjetë muaj përpara se të lajmërohet.

Ju ftoj që ta miratojmë këtë marrëveshje.

Fatjona Dhimitri – Faleminderit!

Fjalën e ka zoti Tola.

Erzen Tola – Faleminderit!

Duke qenë se zëvendësministri e prezantoi memorandum, nuk kam asgjë tjetër për të shtuar.

Në qoftë se do të ketë pyetje, patjetër, jemi të gatshëm t'i sqarojmë.

Fatjona Dhimitri – Cilat janë rrisitë që sjell institucionalizimi i kësaj marrëveshjeje?

Erzen Tola – Atëherë, siç e përmendi edhe zëvendësministri, marrëveshja ka filluar në Republikën e Shqipërisë në vitin 2000, por nuk ka qenë asnjëherë e institucionalizuar nëpërmjet një akti ligjor. Për herë të parë në vitet 2016-2017 ka filluar negocimi i nënshkrimit të marrëveshjes, e cila më pas u miratua në parim nga Këshilli i Ministrave dhe u nënshkrua në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Tashmë e kemi paraqitur për ratifikim në Kuvend, pasi marrëveshja përmban detyrime financiare për Republikën e Shqipërisë.

Fatjona Dhimitri – A kemi ne një monitorim të individëve që kanë përfituar nga këto bursa dhe cili ka qenë kontributi që ata kanë dhënë në vendin tonë?

Erzen Tola – Sikurse e shpjegojam, deri tani nuk ka pasur një akt ligjor për marrëveshjen dhe, për pasojë, nuk ka pasur një monitorim të individëve që kanë shkuar. Por, sigurisht, janë të shumtë individët ose shtetasit shqiptarë që kanë shkuar nëpërmjet këtij programi në Shtetet e Bashkuara të Amerikës për të studiuar. Por Ministria e Arsimit nuk i disponon këto të dhëna, pasi dërgimi i individëve nuk ka qenë i koordinuar nëpërmjet Ministrisë së Arsimit.

Fatjona Dhimitri – Ka pyetje nga anëtarët e tjerë të komisionit? Nuk ka.

Kalojmë në votimin në parim të memorandumit.

Kush është dakord me memorandum?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

E hedhim në votim nen për nen.

Neni 1 “Për ratifikimin e memorandumit të mirëkuptimit ndërmjet qeverisë së Republikës së Shqipërisë (Këshilli i Ministrave) dhe qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës për programin e shkëmbimit akademik “*Fulbright*”, sipas tekstit që i bashkëlidhet projektligjit.”.

Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2: “Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në “Fletoren Zyrtare””.

Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Hapet votimi në tërësi.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po, shprehemi dakord lidhur me ratifikimin e memorandumit të mirëkuptimit ndërmjet dy qeverive. Faleminderit!

Shpresoj që institucionalizimi i marrëveshjes të jetë në të mirë të arsimit shqiptar dhe të të rinjve shqiptarë! Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA